


01-800



Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-104634/22 dt. 13.05.2022, të pronarit Flurije Morina nga Prishtina, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për ndërrimin e destinimit të përdorimit të hapësirës banesore në hapësirë afariste, në rr. “Henry Dunant” në lagjen “Ulpiana”, në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit, në procedurë administrative, me datë 23.05.2022, lëshon këtë:

CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

I. I LEJOHET Flurije Morina nga Prishtina, sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-104634/22 dt. 13.05.2022, përdorimi i lokalit afaristë për të cilin është bërë ndërrimi i destinimit të përdorimit të hapësirës banesore në hapësirë afariste, sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351/02-228465/21 dt. 17.11.2021, të evidentuar në certifikatën e pronësisë O-71914059-0777-0-492-5-1-0, ZK Prishtinë.

II. Ndërtesa nga pika I. e këtij vendimi, ndodhet në rrugën “Henry Dunant”, ku kanë dalje hyrjet e kësaj ndërtese me numrin: 60, në Prishtinë, dhe e njehta do të përdoret dhe shfrytëzohet sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.

III. Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e lokalit në evidencat e regjistrit kadastral.

VI. Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas Shtojca 5 e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

A r s y e t i m

Pronarja Flurije Morina nga Prishtina, me kërkesën me 05 Nr. 391/02-104634/22 dt. 13.05.2022, i është drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për lokalit afaristë për të cilin është bërë ndërrimi i destinimit të përdorimit të hapësirës banesore në hapësirë afariste, dhe i cili gjendet në rrugën “Henry Dunant” në lagjen “Ulpiana” në Prishtinë, konkretisht i evidentuar në certifikatën e pronësisë O-71914059-0777-0-492-5-1-0, ZK Prishtinë, ku ndërrimi i destinimit të përdorimit të hapësirës banesore në hapësirë afariste është bërë sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351/02-228465/21 dt. 17.11.2021, të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës si dhe pranuar teknikisht nga komisioni përkatës.

Paraprakisht Drejtoria e Inspeksionit-Spektori i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës, përmes shkresave zyrtare “Akt përcjellës”, me referencë 09 Nr. 391/02-895185/22 dt. 12.05.2022, ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizmit, Raportet mbi Inspektimin Final të punëve dhe përshkrimin të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, kërkesja ka prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 5 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/1.Inspektimi i themelit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.1.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturave të betonit para instalimit të derdhjes; Lista

kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.2.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e betonit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.c.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e çelikut; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.d.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e drurit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/3.Inspektimi i instalimit elektrik; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/4.Inspektimi i instalimeve të ujit; Fotografji gjatë procesit të ndërtimit; Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testeve, certifikatat; Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, nga mbikqyrësi Eridona Rukiqi; Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikqyrësi Arif Rukiqi; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujësjiellësit dhe kanalizimit, nga mbikqyrësi Labinot Dedushi; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve elektike, nga mbikqyrësi Nexhmedin Durmishi; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve makinerike, nga mbikqyrësi Adem Arifi.

Kjo drejtori, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, mendimit profesional të organit kompetent, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Inspektimit Final, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjiellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht lokalin afaristë për të cilin është bërë ndërrimi i destinimit të përdorimit të hapësirës banesore në hapësirë afariste mund të përdoret .

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezentuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që për ndërrimin e destinimit të përdorimit të hapësirës banesore në hapësirë afariste mund të përdoret, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për lokalin afaristë për të cilin është bërë ndërrimi i destinimit të përdorimit të hapësirës banesore në hapësirë afariste.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Certificate, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI, Departamenti Ligjor i MMPH-së.

Ky vendim u printua në 6 (gjashtë) kopje identike dhe i dërgohet: Kërkuësja, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS.
05 NR. 391/02-104634/22 DT. 23.05.2022

Zyrtarja,
Bahtije Vllasaliu
B. Vllasaliu

U.D. Udhëheqëse e Sektorit,
Nazife Krasniqi

Nazife Krasniqi

